



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **INXHINIERI INFORMATIKE SOFTWARE-SH**

**Niveli i katërt në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit IV të KEK<sup>2</sup>**

**K-T/1-IV-24**

**Tiranë 2024**

---

<sup>1</sup>Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

## Përmbjatja

Emërtimi i kualifikimit .....	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja .....	4
Niveli.....	4
Qëllimi: .....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit: .....	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: .....	4
Ofruesit .....	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit .....	4
<b>STRUKTURA E KUALIFIKIMIT .....</b>	<b>5</b>
Kompetenca të përgjithshme.....	5
<b>NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL: .....</b>	<b>5</b>
<b>T/1-30-IV-0108-24 Ekonomi ndërmarrje .....</b>	<b>5</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	5
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	6
Kriteret e vlerësimit .....	7
<b>T/1-30-IV-0109-24 Menaxhim projektsh dhe sigurim cilësie.....</b>	<b>7</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	7
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	8
Kriteret e vlerësimit .....	9
<b>T/1-19-IV-0110-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit .....</b>	<b>10</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	10
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	10
Kriteret e vlerësimit .....	11
<b>T/1-30-IV-0111-24 Rrjetet kompjuterike.....</b>	<b>11</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	11
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	12
Kriteret e vlerësimit .....	13
<b>T/1-30-IV-0112-24 Programim aplikacionesh.....</b>	<b>13</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	13
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	14
Kriteret e vlerësimit .....	14
<b>T/1-30-IV-0113-24 Zhvillim web .....</b>	<b>15</b>

Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	15
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	16
Kriteret e vlerësimit .....	16
<b>T/1-30-IV-0114-24 Bazat e të dhënave .....</b>	<b>17</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	17
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	17
Kriteret e vlerësimit .....	18
<b>T/1-29-IV-0115-24 Siguria kompjuterike .....</b>	<b>18</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	18
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	19
Kriteret e vlerësimit .....	19
<b>T/1-30-IV-0116-24 Inteligjenca artificiale .....</b>	<b>20</b>
Rezultatet e të nxënit në Njohuri .....	20
Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale.....	21
Kriteret e vlerësimit .....	21
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse: .....	22
Modalitetet e vlerësimit .....	21
Informacion shtesë .....	22
<b>SHËNIM .....</b>	<b>22</b>

<b>Emërtimi i kualifikimit</b>	<b>INXHINIERI INFORMATIKE SOFTWARE-SH</b>			
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>3800-4200 orë<sup>3</sup></b>	<b>Niveli</b>	<b>IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK</b>	<b>Kodi K-T/1-IV-24</b>
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Inxhinieri informatike software-sh”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është “Zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre në nivelin teknik /menaxher i mesëm për t’u punësuar në fushën e inxhinierisë informatike dhe software-ike apo për krijimin e menaxhimin e një biznesi privat, si person fizik ose juridik”.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, që ofrojnë kualifikimin profesional “Inxhinieri informatike software-sh”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;</li> <li>– janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	Me përfundimin me sukses të arsimit në kualifikim profesional “Inxhinieri informatike Software-sh”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi pajiset me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit të teknikut të mesëm në këtë drejtim profesional, që njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.  Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si teknik programimi në: ISP - Internet Service Provider, Telekomunikacion, Call Center, Helpdesk, Support teknik, Programim - frontend, backend - Web dhe Mobile applications, Data warehouse, Programime për biznes dhe industri etj. si dhe të vetëpunësohet (Freelancer) - në fushën e programimit. Me përfundimin e këtij kualifikimi profesional, individi mund të fitojë të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” dhe mundësinë për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
<b>Ofruesit</b>	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
<b>Data e validimit</b>	<i>Prill 2024</i>			
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>				

<sup>3</sup> Orë mësimore 45 min

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Inxhinieri informatike Software-sh” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

## Kompetenca të përgjithshme

*Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.*

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë rrisht dhe ndryshimet.
15. Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

## NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

## T/1-30-IV-0108-24 Ekonomi ndër-marrje

### Rezultatet e të nxënit në Njohuri

1. Të përshkruajë tendencat e zhvillimit të Inxhinierisë informatike Software-sh;
2. Të përshkruajë legjislacionin në fushën e TIK;
3. Të interpretojë legjislacionin e punës dhe të biznesit;
4. Të shpjegojë nivelet hierarkike dhe rëndësinë e komunikimit etik në organizatë;

5. Të shpjegojë rëndësinë e mirë planifikimit të burimeve dhe veprimtarive të punës;
6. Të përshkruajë rëndësinë e raportimit, si dhe mënyrat dhe formatet përkatëse;
7. Të shpjegojë praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
8. Të klasifikojë prioritetet në planin e punës;
9. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës;
10. Të dallojë burimet e nevojshme për realizimin e detyrave;
11. Të shpjegojë llojet e ndryshme të mjeteve dhe pajisjeve të punës, funksionin, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;
12. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
13. Të përshkruajë teknikat e marketingut;
14. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të saktë të terminologjisë teknike dhe profesionale;
15. Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit dhe rregullat e komunikimit me teknikët e operatorët e tjerë;
16. Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
17. Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të literaturës bashkëkohore;
18. Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita;
19. Të listojë llojet e trajnimeve, kurseve teknike e metodat e zhvillimit të karrierës;
20. Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit të udhëzuesve dhe manualeve të përdoruesit sipas niveleve të aksesit;
21. Të listojë autorizimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave;
22. Të listojë llojet e llogarive të inventarit, kapitalit dhe asetëve;
23. Të përshkruajë bilancin vjetor dhe bilancin e thjeshtë të të ardhurave dhe shpenzimeve.
24. Të përshkruajë kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi dhe regjistrimin e tij;
25. Të përshkruajë mundësitë e ndryshme të financimit dhe investimit;
26. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

## **Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale**

1. Të ndjekë dinamikën e zhvillimit të sektorit të TIK në vend dhe botë;
2. Të zbatojë legjislacionin në fushën e TIK;
3. Të zbatojë legjislacionin e punës dhe të biznesit;
4. Të respektojë nivelet hierarkike;
5. Të komunikojë në mënyrë etike në organizatë;
6. Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
7. Të vendosë prioritetet në planin e punës sipas projektit dhe rëndësisë së lëvrimit të detyrës;
8. Të planifikojë burimet materiale, njerëzore dhe veprimtarive të punës;
9. Të ndajë detyrat në ekip sipas veprimtarisë përkatëse;
10. Të monitorojë punën sipas planit ditor, javor dhe mujor;
11. Të përdorë rregullat e komunikimit hierarkik;
12. Të raportojë në mënyrat dhe formatet e duhura;
13. Të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e punës sipas përdorimit të tyre;
14. Të përcaktojë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
15. Të përgatisë një preventiv sipas projektit teknik;
16. Të zbatojë teknikat e negocimit, menaxhimit të mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;

17. Të zbatojë praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
18. Të përdorë teknikat e marketingut;
19. Të përdorë udhëzues dhe manualët sipas niveleve të aksesit;
20. Të sigurojë autorizimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave;
21. Të përdorë llojet e llogarive të inventarit, kapitalit dhe asetëve;
22. Të kryejë bilancin vjetor dhe bilancin e thjeshtë të të ardhurave dhe shpenzimeve;
23. Të zbatojë kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi dhe regjistrimin e biznesit;
24. Të përdorë mundësitë e ndryshme të financimit dhe investimit.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Ndjek dinamikat e zhvillimit të sektorit të TIK në vend dhe botë;
- Zbaton legjislacionin në fushën e TIK;
- Zbaton legjislacionin e punës dhe të biznesit;
- Respekton nivelet hierarkike duke komunikuar në mënyrë etike në organizatë;
- Organizon në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Planifikon burimet materiale, njerëzore dhe veprimtarive të punës sipas kërkesave të projektit dhe prioriteteve të vendosura, në mënyrë eficiente brenda afatit të kërkuar;
- Ndan detyrat në ekip sipas veprimtarisë përkatëse;
- Monitoron punën sipas planit ditor, javor dhe mujor;
- Raporton në mënyrat dhe sipas formateve të duhura;
- Përzgjedh mjetet dhe pajisjet e punës sipas përdorimit të tyre;
- Llogarit saktë koston dhe çmimin e një shërbimi;
- Përgatit një preventiv sipas projektit teknik;
- Zbaton teknikat e negocimit, menaxhimit të mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Zbaton praktikat më të mira për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Përdor udhëzues, manualët si dhe dokumentacionin e duhur teknik në projekt;
- Përdor teknikat e marketingut;
- Siguron autorizimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave;
- Përdor llojet e llogarive të inventarit, kapitalit, dhe asetëve;
- Kryen bilancin vjetor dhe bilancin e thjeshtë të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Zbaton kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi dhe regjistrimin e biznesit;
- Përdor mundësitë e ndryshme të financimit dhe investimit.

## **T/1-30-IV-0109-24 Menaxhim projektsh dhe sigurim cilësie**

### **Rezultatet e të nxënimit në Njohuri**

1. Të përshkruajë projektin IT, atributet dhe kufizimet e tij;
2. Të përshkruajë rolet e aktorëve në menaxhimin e projektit;
3. Të listojë teknikat dhe mjetet e menaxhimit të projektit;
4. Të listojë fazat dhe ciklin jetësor të projektit;
5. Të përshkruajë trendet që kanë ndikuar në menaxhimin e projekteve IT;
6. Të interpretojë zhvillimin e një diagrami (Project Chart);

7. Të shpjegojë krijimin e Work Breakdown Structure – WBS;
8. Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të projektit në afatet e kërkuara dhe në mënyrë eficiente;
9. Të shpjegojë rëndësinë e cilësisë në menaxhimin e projektit;
10. Të përshkruajë rëndësinë e menaxhimit të komunikimit në projekt;
11. Të listojë risqet në menaxhimin e projektit;
12. Të interpretojë kontratat sipas llojit të shërbimit;
13. Të listojë llojet e dokumentacioneve teknike të përdorura në projekt;
14. Të listojë elementët e dokumentimit të një projekti (teknologjitë e zhvillimit të programit, strukturën, funksionalitet, mjetet e zhvillimit, platformat);
15. Të interpretojë zhvillimin e softuerit, duke përfshirë programim në gjuhë të ndryshme programuese, projektimin e arkitekturës së sistemeve, dhe testimin e softuerit;
16. Të përshkruajë hartimin e planeve të testimit, ekzekutimin e testeve, dhe sigurimin e cilësisë së kodit duke zbatuar praktikatat e mira të testimit-it dhe zhvillimit të cilësisë.
17. Të interpretojë fazat e Cikli i Zhvillimit të Software (SDLC, Continuous Integration/Continuous Delivery), duke përfshirë mbledhjen e kërkesave, projektimin, kodimin, testimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen;
18. Të interpretojë modelet e projektimit për krijimin e arkitekturave të softuerit të shkallëzuar dhe mirëmbajtjen e tij;
19. Të interpretojë sistemet e monitorimit për të mbikëqyrur performancën e sistemit dhe identifikuar shenjat e performancës dobët;
20. Të dallojë mjetet e monitorimit për identifikimin e problemeve të sistemit;
21. Të interpretojë error-et dhe log-et e software-ve të sistemit të monitorimit të performancës;
22. Të interpretojë testet e përsëritura për të identifikuar dhe adresuar probleme potenciale gjatë zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve;
23. Të interpretojë metodologjitë e testimit (p.sh., unit testing, integration testing, system testing), framework-et e testimit (p.sh., JUnit, Selenium etj.);
24. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të versioneve (p.sh., Git) për të gjurmuar ndryshimet dhe për të bashkëpunuar me anëtarët e ekipit;
25. Të interpretojë pipeline-t CI/CD (Continuous Integration/Continuous Delivery) për testimin dhe deployment;
26. Të interpretojë metodat e zhvillimit Agile (p.sh. Scrum, Kanban etj.);
27. Të interpretojë dokumentacionin gjithëpërfshirës dhe të përditësuar për kodin, API-t dhe arkitekturën e sistemit.

## **Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale**

1. Të planifikojë burimet e nevojshme për menaxhimin e projektit;
2. Të zbatojë metodat e menaxhimit të projekteve IT sipas trendeve më të mira;
3. Të monitorojë realizimin e detyrave sipas roleve të aktorëve në projekt;
4. Të monitorojë realizimin e fazave dhe ciklit jetësor të projektit;
5. Të përdorë teknikat dhe mjetet e menaxhimit të projektit;
6. Të zbatojë diagramin e projektit (Project Chart);
7. Të komunikojë profesionalisht për zbatimin e projektit;
8. Të vlerësojë risqet në menaxhimin e projektit;
9. Të monitorojë zbatimin e kontratave;
10. Të përdorë dokumentacionin e duhur teknik në projekt;



11. Të zhvillojë softuerin, duke përfshirë programim në gjuhë të ndryshme programuese, projektimin e arkitekturës së sistemeve, dhe testimin e softuerit;
12. Të zbatojë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në IT;
13. Të zbatojë teknikat për hartimin e planeve të testimit, ekzekutimin e testeve, dhe sigurimin e cilësisë së kodit, duke zbatuar praktikatat e mira të testimit dhe zhvillimit të cilësisë.
14. Të përcaktojë rregullat dhe parimet e sigurimit të cilësisë për një sistem të caktuar;
15. Të zbatojë arkitekturat e shkallëzuara të software-t për mirëmbajtjen e tij;
16. Të monitorojë performancën e sistemit kompjuterik nëpërmjet testeve;
17. Të zbatojë teknikat e optimizimit të performancës së sistemit kompjuterik;
18. Të përzgjedhë modelet e ndryshme Cikli i Zhvillimit të Software (SDLC) për sigurimin e cilësisë së software-ve;
19. Të aplikojë praktikatat më të mira në secilën fazë të Cikli i Zhvillimit të Software (SDLC), përfshirë analizën e kërkesave, projektimin, kodimin, testimin, mirëmbajtjen;
20. Të zbatojë testimet manuale/automatike për analizën e software-ve;
21. Të përdorë mjetet e testimit dhe framework-et përkatëse;
22. Të zbatojë teknika efektive monitorimi dhe log-et për të gjurmuar sjelljen e sistemit;
23. Të sigurojë shpërndarje të shpejtë dhe të sigurtë të update-eve të software-ve;
24. Të mbajë dokumentacionin e plotë gjatë Cikli i Zhvillimit të Software (SDLC) së sistemit;
25. Të kontrollojë ndryshimet në software, hardware, dokumentacion gjatë procesit të zhvillimit dhe mirëmbajtjes;
26. Të zbatojë teknikat Agile për zhvillimet iterative dhe bashkëpunuese në grup.

## **Kriteret e vlerësimit**

- Planifikon burimet e nevojshme për menaxhimin e projektit;
- Zbaton metodat e menaxhimit të projekteve IT sipas trendeve më të mira;
- Monitoron realizimin e detyrave sipas roleve të aktorëve në projekt;
- Monitoron realizimin e fazave dhe ciklit jetësorë të projektit;
- Përdor teknikat dhe mjetet e duhura të menaxhimit të projektit;
- Zbaton siç duhet diagramin e projektit (Project Chart);
- Komunikon profesionalisht për zbatimin e projektit;
- Vlerëson risqet në menaxhimin e projektit;
- Monitoron zbatimin e kontratave në mënyrë rigoroze;
- Zbaton standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në IT;
- Zbaton siç duhet rregullat dhe parimet e sigurimit të cilësisë për një sistem të caktuar;
- Zbaton siç duhet arkitekturat e shkallëzuara të software-t për mirëmbajtjen e tij;
- Monitoron performancën e sistemit kompjuterik nëpërmjet testeve;
- Zbaton teknikat e optimizimit të performancës së sistemit kompjuterik;
- Përzgjedh modelet e duhura Cikli i Zhvillimit të software (SDLC) për sigurimin e cilësisë së software-ve;
- Aplikon praktikatat më të mira në secilën fazë të Cikli i Zhvillimit të Software (SDLC), përfshirë analizën e kërkesave, projektimin, kodimin, testimin dhe mirëmbajtjen;
- Kryen testimet manuale/automatike të duhura për analizën e software-ve;
- Përdor mjetet e testimit dhe framework-et përkatëse;
- Zbaton teknika efektive monitorimi dhe log-et për të gjurmuar sjelljen e sistemit;
- Siguron shpërndarje të shpejtë dhe të sigurtë të update-eve të software-ve;
- Mban dokumentacionin e plotë gjatë Cikli i Zhvillimit të Software (SDLC) së sistemit;

- Kontrollon ndryshimet në software, hardware dhe dokumentacion gjatë procesit të zhvillimit dhe mirëmbajtjes;
- Zbaton teknikat Agile për zhvillimet iterative dhe bashkëpunuese në grup.

## **T/1-19-IV-0110-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

### **Rezultatet e të nxënit në Njohuri**

1. Të interpretojë rregullat bazë për hartimin e manualit në përdorimin e pajisjeve të punës;
2. Të interpretojë standardet dhe legjislacionin në fuqi lidhur me rregullat e sigurimit teknik;
3. Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të interpretojë përdorimin e sinjalistikave në mjediset e brendshme të ndërtesës dhe në terren sipas legjislacionit në fuqi;
5. Të shpjegojë procedurat respektive sipas planit të evakuimit në raste emergjence;
6. Të listojë rregullat bazë për shpëtimin dhe mbrojtjen ndaj zjarrit;
7. Të interpretojë masat mbrojtëse për punën sipas protokolleve për sigurimin teknik;
8. Të shpjegojë përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë;
9. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste endemie dhe pandemie;
10. Të listojë rregullat bazë për mbrojtjen nga rrezatimet;
11. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen ndaj rrymave ose tensionit;
12. Të shpjegojë protokollin e evakuimit në raste emergjence;
13. Të interpretojë procedurat e asgjësimit të pajisjeve elektronike të dala jashtë përdorimit;
14. Të përshkruajë rëndësinë e ekonomisë së gjelbër dhe impaktin e saj në sektor;
15. Të shpjegojë rregullat bazë për ndarjen e mbetjeve sipas llojit para transportimit;
16. Të listojë masat për ruajtjen dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës, në përputhje me rregulloret e mjedisit;
17. Të shpjegojë rëndësinë dhe rregullat për përdorimin e energjisë dhe materialeve, në mënyrë racionale;
18. Të shpjegojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

### **Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale**

1. Të monitorojë zbatimin e manualeve përkatëse në përdorimin e pajisjeve;
2. Të zbatojë legjislacionin lidhur me sigurimin teknik;
3. Të demonstroj dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të monitorojë respektimin e sinjalistikës në mjediset e brendshme dhe në terren;
5. Të demonstroj zbatimin e një plani evakuimi në raste emergjence;
6. Të respektoj rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit;
7. Të përdorë mjetet e duhura mbrojtëse në punë;
8. Të demonstroj zbatimin e masave mbrojtëse në punë;
9. Të demonstroj rregullat për mbrojtjen nga rrezatimet;
10. Të demonstroj rregullat për mbrojtjen ndaj rrymave ose tensionit;
11. Të respektoj rregullat dhe procedurat përkatëse të asgjësimit të mjeteve dhe pajisjeve TIK jashtë përdorimit;
12. Të zbatojë rregullat për ndarjen së mbeturinave sipas llojit;
13. Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
14. Të demonstroj zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit.

## **Kriteret e vlerësimit**

- Zbaton manualet përkatëse gjatë përdorimit të pajisjeve për mbrojtjen në punë;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Respekton sinjalistikën në mjediset e brendshme të ndërtesës dhe në terren sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse.
- Përdor në mënyrë korrekte mjetet mbrojtëse në punë;
- Zbaton në mënyrë rigoroze protokollet e duhura në raste pandemie dhe endemie;
- Zbaton në mënyrë rigoroze rregullat për mbrojtjen nga rrezatimet;
- Zbaton në mënyrë rigoroze rregullat për mbrojtjen ndaj rrymave ose tensionit;
- Zbaton procedurat e asgjësimit të pajisjeve elektronike të dala jashtë përdorimit duke zbatuar procedurat e përcaktuara;
- Kontrollon zbatimin e rregulloreve për ndarjen e mbetjeve sipas llojit para transportimit;
- Kontrollon ruajtjen dhe depozitimimin e mbetjeve nga procesi i punës, në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Përdor në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
- Zbaton projektet TIK duke respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

## **T/1-30-IV-0111-24 Rrjetet kompjuterike**

### **Rezultatet e të nxënit në Njohuri**

1. Të shpjegojë komponentët fizikë të rrjetit dhe përdorimin e tyre (router, switch, access point etj.);
2. Të përshkruajë teknikat e adresimit të komponentëve dhe rrugëzimit të saktë të të dhënave nëpërmjet konfigurimit të IP, Hostname, NetworkPath etj.;
3. Të interpretojë infrastrukturën “point to point” dhe “point to multipoint”;
4. Të përshkruajë llojet e portave dhe linjave fizike të komunikimit në rrjet;
5. Të shpjegojë llojet e rrjetit PAN, LAN, MAN, WAN, VPN, SDN, WLAN etj.;
6. Të interpretojë rrjetat internetworks, Internet, Cloud etj.;
7. Të interpretojë diagramin e detajuar të rrjetit kompjuterik, adresat MAC, versionin e software-t, numri serial etj.;
8. Të shpjegojë protokollet e rrjetit, Ipv4, Ipv6, TCP/IP, UDP, SMTP, SSH, FTP, HTTPS etj.;
9. Të përshkruajë topologjitë e rrjetit kompjuterik, point-to-point, bus, star, ring, mesh, hybrid, daisychain etj.;
10. Të listojë komandat: ping, tracert, arp, ipconfig, netstat, nslookup, whois dhe parametrat përkatës;
11. Të përshkruajë konceptet Network speed, Jitter, Packetloss, Latency, Throughput, QoS, Response Time, Network bandwidth, Network congestion etj.;
12. Të përshkruajë mjetet (tools) e ndryshme si testuesit të rrjetit, ApacheJmeter, Gatling, Locust, FileZilla, SCP etj.;
13. Të shpjegojë simulimin e skenarëve të rrjetit, duke përdorur software përkatës simulues (si psh. Cisco Packet Tracer);

14. Të listojë analizatorë të rrjetit WiFi, WiFianalyzer, Wireshark, NetSurveyor, NetSpotDiscover, InSSIDer etj. dhe përdorimet e tyre;
15. Të dallojë protokollin e sigurisë WPA, WPA2, WPA3 etj.;
16. Të përshkruajë shtresat e modelit OSI dhe TCP;
17. Të përshkruajë programet Microsoft Visio, Docusnap, NetBox, NetBrain etj.
18. Të shpjegojë Active Directory, domain controller, protokollin LDAP etj.;
19. Të interpretojë konceptet socket, arkitekturën client-server, llojet e stream, datagram etj.;
20. Të përshkruajë multithreading dhe konkurrencën e lidhjeve të njëkohshme;
21. Të shpjegojë mënyrat e komunikimit të nyjeve në sistemet e shpërndara;
22. Të përshkruajë libraritë e rrjetit dhe framework-et përkatëse të programimit në rrjet;
23. Të shpjegojë strategjitë për trajtimin e gabimeve gjatë programimit në rrjet.

## **Rezultatet e të nxënit në Shprehi profesionale**

1. Të kryejë instalimet dhe konfigurimet e komponentëve fizikë të rrjetit;
2. Të kryejë lidhjet dhe konfigurimet për rrjetat PAN, LAN, MAN, WAN, VPN, SDN, WLAN etj.;
3. Të përdorë teknikat e adresimit të komponentëve dhe rrugëzimit të saktë të të dhënave nëpërmjet konfigurimit të IP, Hostname, NetworkPath.
4. Të kryejë konfigurimet e nevojshme për infrastrukturën “point to point” dhe “point to multipoint”;
5. Të kryejë lidhjet e portave dhe linjave fizike të komunikimit në rrjet;
6. Të kryejë konfigurimet e nevojshme për internetworks, Internet, Cloud etj.;
7. Të kryejë konfigurimet për protokollin e rrjetit, Ipv4, Ipv6, TCP/IP, UDP, SMTP, SSH, FTP, HTTPS etj.;
8. Të zbatojë udhëzimet për ndërtimin e rrjetit kompjuterik, sipas topologjisë (point-to-point, bus, star, ring, mesh, hybrid, daisychain etj.);
9. Të përdorë komandat: ping, tracert, arp, ipconfig, netstat, nslookup, whois etj.;
10. Të monitorojë parametrat e Network speed, Jitter, Packetloss, Latency, Throughput, QoS, Response Time, Network bandwidth, Network congestion etj.;
11. Të përdorë mjetet e ndryshme testimi të rrjetit (ApacheJmeter, Gatling, Locust, FileZilla, SCP etj.);
12. Të simulojë skenarët e rrjetit duke përdorur software përkatës simulues (si psh. Cisco Packet Tracer);
13. Të përdorë analizatorë të rrjetit WiFi, WiFianalyzer, Wireshark, NetSurveyor, NetSpotDiscover, InSSIDer etj.;
14. Të zbatojë protokollin e sigurisë (WPA, WPA2, WPA3 etj.);
15. Të zbatojë udhëzimet për përdorimin e protokolleve OSI dhe TCP;
16. Të përdorë programet Microsoft Visio, Docusnap, NetBox, NetBrain etj.
17. Të konfigurujë Active Directory, domain controller, protokollin LDAP etj.;
18. Të kryejë konfigurimet e nevojshme për socket, arkitekturën client-server, llojet e stream, datagram etj. ;
19. Të përdorë multithreading;
20. Të kryejë lidhjen e nyjeve në sistemet e shpërndara;
21. Të përzgjedhë libraritë e rrjetit dhe framework-et përkatëse të programimit në rrjet;
22. Të zbatojë metodat për trajtimin e gabimeve gjatë programimit në rrjet.

## **Kriteret e vlerësimit**

- Kryen instalimin dhe konfigurimin e komponentëve fizikë të rrjetit sipas projektit;
- Kryen lidhjet dhe konfigurimet për rrjetat PAN, LAN, MAN, WAN, VPN, SDN, WLAN etj., sipas strukturës së rrjetit dhe projektit;
- Kryen adresimin e saktë të komponentëve dhe rrugëzimit të saktë të të dhënave nëpërmjet konfigurimit të IP, Hostname, NetworkPath etj.;
- Kryen saktë konfigurimet e nevojshme për infrastrukturën “point to point” dhe “point to multipoint” sipas kërkesave të projektit;
- Kryen, në mënyrë të saktë, lidhjet e portave dhe linjave fizike të komunikimit në rrjet sipas diagramës;
- Kryen saktë konfigurimet e nevojshme për internetworks, Internet, Cloud etj.;
- Kryen konfigurimet e duhura të parametrave për protokollat e rrjetit, Ipv4, Ipv6, TCP/IP, UDP, SMTP, SSH, FTP, HTTPS etj.;
- Zbaton me përpikmëri udhëzimet për topologjitë e rrjetit kompjuterik, point-to-point, bus, star, ring, mesh, hybrid, daisychain etj.;
- Përdor saktë komandat: ping, tracer, arp, ipconfig, netstat, nslookup, whois etj.;
- Monitoron siç duhet parametrat e rrjetit si p.sh.: Network speed, Jitter, Packetloss, Latency, Throughput, QoS, Response Time, Network bandwidth, Network congestion etj.;
- Përdor me efikasitet mjetet e ndryshme si testuesit të rrjetit, ApacheJmeter, Gatling, Locust, FileZilla, SCP etj.;
- Realizon simulimin e skenarëve të rrjetit sipas udhëzimeve;
- Përdor saktë dhe me etikë programet analizues të rrjetit WiFi: WiFianalyzer, Wireshark, NetSurveyor, NetSpotDiscover, InSSIDer etj.;
- Zbaton saktë protokollat e sigurisë, WPA, WPA2, WPA3 etj.;
- Zbaton me përpikmëri udhëzimet për përdorimin e protokolleve të rrjetit OSI dhe TCP/IP;
- Përdor në mënyrë eficiente programet Microsoft Visio, Docusnap, NetBox, NetBrain etj.;
- Konfiguron Active Directory sipas udhëzimeve dhe infrastrukturës IT;
- Kryen konfigurimet e nevojshme për socket, arkitekturën client-server, llojet e stream, datagram etj., sipas projektit;
- Kryen lidhjen e nyjeve në sistemet e shpërndara sipas projektit dhe infrastrukturës;
- Përzgjedh saktë framework-et përkatëse të programimit në rrjet sipas praktikave më të mira;
- Zbaton, siç duhet, strategjitë për trajtimin e gabimeve gjatë programimit në rrjet.

## **T/1-30-IV-0112-24 Programim aplikacionesh**

### **Rezultatet e të nxënimit në Njohuri**

1. Të listojë mjedise (IDE) të ndryshme për zhvillimin e app desktop dhe mobile;
2. Të dallojë framework-et e duhura për zhvillimin e app;
3. Të shpjegojë përdorimin e platformave për menaxhimin e projektit (Git dhe Github);
4. Të interpretojë elementët e dizajnit dhe teknikat përkatëse UI/UX;
5. Të dallojë llojet e algoritmeve dhe funksionet kryesore;
6. Të interpretojë algoritmet mbi bazën e kriterëve të kompleksitetit dhe efikasitetit;
7. Të dallojë software-t e vizualizimit të ndërfaqes;
8. Të interpretojë strukturat e kushtëzuara, ciklet dhe llojet e strukturave të të dhënave statike e dinamike;

9. Të interpretojë kodin sipas sintaksës së gjuhës së programimit të përzgjedhur;
10. Të shpjegojë funksionimin e trashëgimisë dhe funksioneve polimorfe;
